



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada- Government

Ministriu e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Buxhetit - Department Budzeta - Budget Department

DATE	08.05.2024
REFERENCË	WV-SD 12324
PËR/ZA/TO:	z. Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore, Zyra e Kryeministrit
CC:	z. Arben Krasniqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm, ZKM
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Enis Spahiu, U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, MFPT
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion i departamentit të buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e "Amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016"

I nderuar z. Borovci,

Bazuar në kërkesën e Zyrës së Kryeministrit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e "Amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016" të paraqitur nga Zyra e Kryeministrit, obligimit nga nenë 9 i Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Departamenti i Buxhetit të Kosovës, paraqet me sa vijon:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Projektligji për Ratifikimin e Amendamentit nr.2 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2016, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka për qëllim amendamentimin e programit vjetor IPA 2016 përmes së cilës bëhet zgjatja e afatit për zbatimin e programit vjetor IPA 2016 edhe për 2 vite shtesë me qëllim të zbatimit të projekteve që janë ballafaquar me vonesa.. Marrëveshja financiare për IPA 2016 definojnë asistencën e dhënë nga BE për Kosovën në kuadër të IPA 2016.

II. OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) NGA ORGANI PROPOZUES

Zyra e Kryeministrit si organ propozues e ka dërguar vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky Projektligj nuk ka kosto buxhetore, meqenëse të gjitha fondet janë zotuar dhe kontraktuar nga Bashkimi Evropian më parë, ndërsa përmes këtij amendamenti tani bëhet shtyja e afatit të zbatimit të projekteve të kontraktuara edhe për 2 vite.

III. PËRFUNDIM

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Ratifikimin e Amendamentit nr.2 të Marrëveshjes Financiare për IPA 2016, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, nuk krijon kosto shtesë buxhetore për vitin 2024-2026 për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe zbatimi i të gjitha aktiviteteve që rrjedhin nga ky Projektligj do të mbulohet nga Bashkimi Evropian si donator.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk merr për obligim që nga Buxheti i Republikës së Kosovës të financoj aktivitetet të cilat janë të parapara të financohen nga donatorët.

Përgatitur nga:

Azem Reqica, Analist i lartë i buxhetit _____

Konfirmoi: Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror _____